



S'ka progres dhe demokraci në qoftëse gjysma e popullatës s'është e kyqur në vendimarrje. Nuk mund të ketë vendim të drejtë në qoftëse gratë nuk janë të kyqura në mënyrë të barabartë në sjelljen e vendimeve. Poashtu mungesa e grave nga qeverisja vendore dhe ajo nacionale në fillim të viteve 90 – ta është motivi kryesor për hapjen e pyetjes për pjesmarrjen e grave në politikë dhe në strukturat vendimarrëse. LOGM 10 vite në kontinuitet punon në fushën e fuqizimit të grave në politikë duke ngritur iniciativa, duke zhvilluar trajnime dhe duke bërë lobim.

LOGM bën përpjeke për pjesmarrje më të madhe të grave në politikë, shumë e rëndësishme është puna e cila është zhvilluar në kontinuitet si dhe realizimi i proektit **"Gratë mund t'ia arrijnë II – Zgjedhjet vendore"**. Ky proekt ka domethënien e vënies së konceptit gjinor nga partitë politike për tu mundësuar gravetë bëhen subjekt aktiv në sjelljen e vendimeve.

Bashkëpunimi i vendosur midis LOGM si organizatë joqeveritare dhe Departamentit për përparimin e barazisë midis gjinive pranë MPPS si institucion qeveritar, partitë politike dhe OSBE – ja si organizatë ndëkombëare paraqet model për arritje të rezultateve pozitive prej 8,4% gra këshilltare në 22,4% në Zgjedhjet vendore të vitit 2005.

*Elena Grozdanova
Savka Todorovska*

Gjatë vitit të kaluar, Misioni i OSBE-së pati bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë LOGM dhe Departamentin për përparimin e barazisë gjinore, ku realizuan një numër të madh projektsh dhe iniciativash me qëllim që të avancohet barazia gjinore në vend.

Andaj mendoj se implementimi i projektit "Gratë mund t'ia arrijnë II- 2005- Zgjedhjet vendore" paraqesin një program me qasje multidimensionale për arritjen e këtij qëllimi.

Këshilli i përgjithshëm i OSBE-esë në dhjetor të vitit 2004 e miratoi planin veprues për fuqizimin e barazisë gjinore në rajonet e OSBE-esë dhe të sigurojë vëzhgim në implementimin e të njejtit. Miratimi i planit tregon se OSBE-ja vazhdon të luajë rol të madh në përparimin e barazisë gjinore. Rezultatet e zgjedhjeve të paradokohshme vendore treguan se është bërë një hap përpara në përmirësimin e pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në sjelljen e vendimeve politike në jetën publike dhe politike.

Krahasuar me zgjedhjet lokale të vitit të kaluar numri i grave të zgedhura në këshillet e komunave u rrit nga 8,4 % në 22,4% (312). Për fat të keq të gjitha partitë politike nuk e respektuan kuotën 30% që ishte kusht ligjor nga viti 2004, i cili ju mundësonte grave të jenë njësoj të përfaqësuar në pjesën e parë dhe të dytë të listave dhe vetëm tri gra (3,5%) u zgjedhën për prefekte.

Numri i grave të zgedhura në këshillet e komunave u rrit nga 8,4 % në 22,4% (312)

Misioni i OSBE-së beson se përfundimet dhe të dhënat nga projekti duhet të analizohen dhe përvojat e fituara të aplikohen në të ardhmen respektivisht në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Projekti tregoi se çështja lidhur me barazinë gjinore po bëhet shumë e rëndësishme për shumë parti politike të cilat morrën pjesë në projektin "GMA II".

Misioni i OSBE-së do të vazhdojë të jep përkrahjen e vet për shoqërinë civile në implementimin e aktiviteteve për përmirësimin e pozitës së gruas.

*Elena Gulmadova
OSBE - Zyrtare për sundimin e së drejtës
OSBE – Misioni Vëzhgues në Shkup*



Hyrje

Lidhja e organizatave të grave në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit 2004-2005 e realizoi projektin nacional "Gratë mund t'ia arrijnë II-Zgjedhjet vendore 2005" në partneritet me Sektorin për përparim dhe barazi gjinore pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe në bashkëpunim me Paktin e Stabilitetit Grupi punues për Barazi gjinore (SP GTF). Projekti përmbahet financiarisht nga misioni i OSBE-së në Shkup.

Qëllimi kryesor i projektit

Zmadhimi i pjesëmarrjes së grave në strukturat vendimmarrëse në nivel lokal në vend.

Qëllimet e projektit

- Sjellja e amendamentit në Ligjin për zgjedhje vendore, i cili siguron 30% kuotë për të dy gjinitë në listat zgjedhore për këshilltarë dhe prefektë;
- Zmadhimi i përkrahjes nga ana e partive politike dhe opinionit për promovimin e tij dhe barazia gjinore, në procesin e fuqizimit të gjinisë femërore në politikë;
- Zmadhimi i numrit të grave të zgjedhura në këshillat e komunave në zgjedhjet e ardhshme vendore;

Grupet qëllimore në poret

Liderët e politikës, lideret e forumeve të grave në partitë politike, kandidatet për prefekte dhe këshilltarë, si dhe votuesit dhe opinionit.

Orari i seminareve në partitë politike

Partia politike	Organizatorët e seminareve nga partitë politike	Vendi	Data
LSDM	Snezhana Orloviq	Shkup	Maj 22- 23, 2004
BDI	Halide Palloshi	Strugë	Shtator 9 – 10, 2004
PLD	Menka Gugulevska	Shkup	Qershor 26 –27, 2004
PPD	Ferdeze Sulejmani	Tetovë	Korrik 3 – 4, 2004
PLM	Golubka Neçevska Cvetanovska	Radovish	Qershor 12 – 13, 2004
VMRO/ DMPNE	Irena Misheva	Shkup	Tetor 23 – 24, 2004
PDSH	Vildane Palloshi	Tetovë	Qershor 5 – 6, 2004
PSM	Vera Çerepnalkova	Shkup	Maj 22 – 23, 2004
PBER	Iseni Hariet	Shkup	Tetor 28 – 29, 2004
AD	Snezhana Gulevska	Shkup	Maj 15 – 16, 2004

Aktivitetet e realizuara

- Është formuar Bordi i projektit, përgjegjës për implementimin e projektit i cili përbëhet nga një koordinator, një asistente e projektit, dy trajnere eksperte (të trajnuara në seminarin regjional të SP GTF) lidere të partive politike (përfaqësues të partive politike);
- Është nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim me liderët e partive politike në lidhje me implementimin e aktiviteteve të cilat i përkasin projektit;
- Prezentimi i projektit në opinion (për votuesit) përmes mediave;
- Janë realizuar 10 seminare me 10 parti politike: LSDM, BDI, VMRO-DPMNE, PLD, PLM, PDSH, PPD, AD, PSM dhe PBERM.
- Raport për statusin: Përfaqësueset e partive politike në Bordin e projektit me ndihmën e anëtarëve tjerë të bordit përgatitën Raport për statusin, përgatitur nga të dhënat statistikore të partive politike për promovimin dhe aplikimin e barazisë gjinore në çdo parti politike e përfshirë me këtë projekt;
- Raport për vlerësimin legjislativ i përgatitur nga z-nja Zagorka Tnokovska;
- Raporti për përfaqësimin në media i përgatitur nga z-nja Biljana Bejkova;
- Konferencë për vlerësim
- Analizë gjinore e listave kandiduese
- Vlerësim përfundimtar i projektit i përgatitur nga z-nja Sonja Lokar

Pjesëmarrës

Numri i përgjithshëm i grave dhe burrave të trajnuar, politikanë: 242

- 238 gra nga politika
- 4 burra nga politika (3 nga PSM dhe 1 nga PL)

Niveli i organizuar i pjesëmarrësve

- 57% me shkollim superior
- 31% me shkollim të mesëm
- 12% studentë

Nga numri i përgjithshëm të punësuar janë 63%, kurse të tjerët 37% janë të papunësuar.

Konferenca për vlerësim

Konferenca evaluative - 10.12.2004.

Klubi i parlamentarëve, Shkup

Të pranishëm 60 pjesëmarrës prej të cilëve 53 gra nga parti të ndryshme politike nga pozita dhe opozita.



Konferenca evaluative - 10.12.2004.

Klubi i parlamentarëve, Shkup





Ndikimet e projektit „Gratë mund t’ia arrijnë II 2004-2005“

- Evaluimi final - Maj 2005

Ç’ËSHTË NDRYSHUAR?

Ç’FARË ENDE PARAQET PROBLEM?

Në peridhën e vitit 2002 kur realizohej projekti “Gratë mund t’ia arrijnë II” të gjitha 10 partitë politike ishin të udhëhequra nga liderë politik meshkuj. Asgjë nuk ndryshoi deri në vitin 2004.

Trajnuesit e partive politike nuk dhanë raporte për anëtarët e tyre me të cilët opinioni do të njihej me gratë të cilat do të jenë politike të veçuara në nivel nacional dhe lokal.

Ky është tregues se pothuajse të gjitha partitë kanë mungesë të grave politike në profiluar në nivel nacional e sidomos në atë lokal.

Në vitin 2002 tri parti politike nuk kishin organizatë femërore në nivel nacional, njëra kishte vetëm grup joformal të grave dhe 6 parti kishin organizatë formale të grave. Vetëm dy vite më vonë të gjitha 10 partitë politike në mënyrë formale bënë organizimin e organizatave femërore në nivel lokal.

Në vitin 2002 vetëm katër parti nga projekti e kishin të përfshirë në programin e tyre barazinë gjinore (më e mira ishte PLD), vetëm dy parti kishin kuotën për gjinitë në statutet e tyre (LSDM dhe PLM) dhe njëra nga ato (PLM) vetëm për organet partiake. Para zgjedhjeve parlamentare në vitin 2002 përqindja e grave në parlament ishte 7,6%.Përfitim më të madh nga projekti i parë “Gratë mund t’ia arrijnë II” ishin :

- Ligjësimi i kuotës 30% për Zgjedhjet parlamentare;
- Aftësia e grave për të lobuar së bashku (Aksion i Lobit të grave të Maqedonisë) për sa është e mundshme më shumë gra në pozita fituese sepse kuota në Ligj nuk kishte dispozita për gratë kandidatë;
- Zmadhimi i numrit të grave në parlament prej 7,6% në 18,33%

Partitë, të cilat kishin mundësi të japin ndonjë statistikë për anëtarësinë e tyre në baza gjinore, mundeshin të japin përgjegje të sakta vetëm në një numër të caktuar pyetjesh.

Situata në vitin 2004 është krejtësisht ndryshe: përafërsisht të gjitha partitë e dinin strukturën gjinore të votuesve të tyre, të gjitha 10 partitë kanë të dhëna të ndara nga aspekti gjinor për anëtarësinë si dhe anëtarët femra, në legjislativë dhe strukturat e qeverisjes në nivel nacional. Por ata ende nuk kanë një mbikqyrje të duhur të situatës në nivel lokal me përjashtim të të dhënave për gratë prefekte (shikoni tabelat 1,2,3.)

Ky është një tregues i qartë se organizatat femërore brenda partive ende janë të organizuara shumë pak ose lidhja e këtyre në nivel lokal dhe nacional është e kohë paskohëshme dhe e dobët.

Tabela 1: Letërnjoftimi i partive pjesëmarrëse në vitin 2004 ▼

Parti-të	Kryetari	Grupet femërore	Kryetare e gr.femëror	Anëtar në parlament %	Gratë parlamenta-re
LSDM	Vlado Buçkovski	organizim formal	Eleonora Petrova Mitrevska	35,8%	27,0%
BDI	Ali Ahmeti	organizim formal	Azize Velin	13,3%	6,2%
PLD	Risto Penov	organizim formal	Liljana Popovska	9,0%	45,4%
PPD	Abdulme-naf Bexheti	organizim formal	Ferdeze Sulejmani	1,6 %	0%
PLM	Stojan Andov	organizim formal	Golubka Neçevska Cvetanovska	4,2%	20,0%
VMRO/DMPNE	Nikola Gruevski	organizim formal	Silvana Boneva	22,0%	15,0%
PDSH	Arben Xhaferi	organizim formal	Vildane Palloshi	5,8%	0%
PSM	Љубисав Иванов	organizim formal	Vera Çerepnalkova	0,8%	0%
PBERM	Nexet Mustafa	organizim formal	Izeni Hanriet	0,8%	0%
AD	Vasil Tupurkovs	organizim formal	Zhaklina Servini	0%	0%


Tabela 2: Fakte dhe numra për gratë dhe burrat në partitë ▼

	СДСМ	ДУИ	ЛДП	ПДП	ЛПМ	ВМРО ДМПНЕ	ДПА	СПМ	ОПЕРМ	ДА
% GRA VOTUESE	n / p	50%	55%	50%	50%	55%	37%	20%	39%	42%
% GRA ANËTARE TË PARTISË	38,3%	35%	37,8%	n / p	38,5%	52%	29%	30%	30%	45,5%
% KUOTA PËR ORGANET PARTIAKE	30%	30%	n / p	30%	40%	n / p	20%	30%	n / p	30%
KUOTAT PËR LISTAT PARTIAKE %	30%	30%	30%	30%	30%	30%	He	30%	He	30%
RESPEKTIMI I KUOTËS PREJ 30%	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
% GRA KANDIDATE NË ZGJEDHJET E FUNDIT PARLAMENTARE	36%	15%	37%	30%	30%	30%	30%	30%	n / p	30,8%
% GRA NË UDHËHEQËSINË PARTIAKE NË NIVEL NACIONAL	30%	6,2%	18,2%	17,3%	13,6%	23%	20%	20%	0%	28%
% GRA NË UDHËHEQËSINË PARTIAKE NË NIVEL LOKAL	30%	25%	6,8%	n / p	43,8%	43%	20%	20%	20%	32%

Tabela 3: Gratë nga partitë në pozitat e fuqisë ▼

	LSDM	BDI	PLD	PPD	PL	VMRO/ DMPNE	PDSH	PSM	PBERM	AD
KRYETARE E PARTISË	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO
ZËVENDËS KRYETARE	PO	PO	JO	PO	JO	PO	JO	JO	JO	PO
SEKRETAR GJENERAL	JO	PO	PO	JO	JO	PO	JO	JO	JO	JO
% E GRAVE KËSHILLTARE	11	30	10.1	2 gra	14.3	22	n / p	3.3	5	18.7
NUMRI I GRAVE PREFEKTE	JO	JO	1	JO	JO	JO	1	JO	JO	1
GRA KRYETARE TË PARLAMENTIT	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO
GRA ANËTARE TË PARLAMENTIT	27	6.2	45.4	JO	20	15	JO	JO	JO	JO
GRA MINISTRE %	11,5	0	16	0	0	0	0	0	0	0

Nga tabelat 2 dhe 3 mund të shihet se situata në mënyrë drastike ka ndryshuar për dy vite: Në vitin 2004, shtatë nga dhjetë partitë kanë kuotë të veçantë për organet partiake e cila respektohet .Dy parti (LSDM dhe PLD) kanë më tepër se 30% gra candidate në zgjedhjet e fundit parlamentare, pesë parti kanë grua zëvendës kryetare, dy parti kanë grua si sekretare gjenerale. Përqindja e grave ministre ngadalë shënon rritje.



GJENDJA E ORGANIZATAVE POLITIKE FEMËRORE NË SUAZAT E PARTIVE TË TYRE

Të gjitha partitë të përfshira në projekt kanë organizata femërore formale.

Ekzistojnë shumë rregulla se si grupet femërore e formojnë anëtarësinë e tyre.

Në disa nga partitë, të gjitha gratë automatikisht janë anëtare të organizatës femërore. Vetëm në tri nga partitë (PLD, BDI dhe AD) gratë sipas vullnetit vendosin se a do të jenë apo jo anëtare të organizatës femërore. Në dy parti (LSDM dhe PLD) gra të cilat nuk janë të partisë janë anëtare të organizatës femërore të partisë. Një parti (AD) ka përmendur se meshkuj anëtarë të partisë po ashtu janë pjesë e organizatës femërore.

Të gjitha organizatat femërore (OF) pranë partive kanë degë lokale ose klube, kurse një parti (PPD) deklaroi se këto degë lokale nuk janë aq aktive.

Programi OF është pjesë e integruar në programin e partisë, në të shumtën e rasteve (7 raste). Disa nga këto organizata kanë program shtues për barazi gjinore (3 raste) ose Deklaratë programore (Forumi i gruas i PLD). Vetëm në PPD dhe VMRO-DPMNE, organizatat femërore partiake kanë programe të pavarura për barazi gjinore. Vetëm një parti, VMRO-DPMNE ka program të veçantë edukativ për gratë anëtare.

Të gjitha organizatat femërore partiake përveç PDSH-së kanë marrë pjesë në punën e Lobit të grave në vend. Gratë nga PDSH-ja vërejnë se ato nuk janë ftuar të përfshihen në punën e Lobit dhe dhanë propozim për ndryshimin e këtij Lobi: Lobi i grave nga Maqedonia

Të gjitha OF, të cilat morën pjesë në këtë projekt, treguan interesim për ndërtimin e rrjetit të OF në suazat e LGM.

Në parlament ekziston grup jo formal i cili merret me barazi gjinore. Klubi i grave parlamentare. Gratë parlamentare, nga të gjitha partitë, bashkëpunojnë me këtë klub.

BASHKËPUNIMI MIDIS ORGANIZATAVE FEMËRORE PARTIAKE, GRAVE NGA OJQ DHE GRATË AKTIVISTE NGA SINDIKATA

Të gjitha organizatat femërore pranë partive në princip janë të vetëdijshme për rëndësinë e bashkëpunimit me gratë nga OJQ-të. Dy nga ato kanë deklaruar se bashkëpunojnë me të gjitha (PDSH dhe PPD) kurse PBERM tha se ato bashkëpunojnë me 60% nga OJQ-t në vend. Organizatat partiake femërore të cilat emëruan OJQ si partnere të tyre janë: LSDM, PLD, PLM, VMRO-DPMNE, PSM dhe AD. Shumë shpesh OJQ-të janë përmendur në rolin e partnerit të OFP (Organizata femërore partiake) OJQ-të: LOGM, LGM, ESE.

Të gjitha OFP me përjashtim të OPBERM kanë deklaruar se bashkëpunojnë me gratë aktiviste në sindikatë

DUKSHMËRIA E ORGANIZATAVE PARTIAKE FEMËRORE NË MEDIUME, DUKSHMËRIA INDIVIDUALE E GRAVE POLITIKANE NË OPINION

Shumica e OFP kanë deklaruar se ato kanë përvojë për të organizuar pres konferenca në mënyrë të pavarur (përjashtim bëjnë PPD dhe PBERMP).

Secila nga partitë tanimë ka së paku 1-5 gra politikane të cilat janë mjaft të njohura në opinion, në nivel nacional (ministre, nënkryetare në parlament, parlamentare, zëvendës kryetare të partive, drejtoresha të institucioneve qeveritare) dhe 5-20 gra politikane të cilat në mënyrë cilësore janë të trajnuara në nivel lokal (gra prefekte këshilltare, drejtoresha të institucioneve lokale).

Më e dobët si në nivel lokal ashtu edhe në atë nacional është PBERM e poashtu edhe PLM ndihet ende e pasigurt në këtë aspekt.

PROGRAMET E PARTIVE LIDHUR ME BARAZINË GJINORE

- LSDM ka deklarata të përgjithshme për përkrahjen e barazisë gjinore por nuk ka formuluar politika konkrete.
- PLD ka program të përgjithshme për barazinë gjinore, rezolutë partiake lidhur me këtë çështje, dhe deklaratë programore të grupit të veçantë të grave (Forumi i grave). Në zgjedhje ato i përfshijnë pyetjet për barazinë gjinore në programet e tyre zgjedhore;
- PPD: Në program janë përfshirë aktivitete për barazimin gjinor dhe për përmirësimin e statusit të grave në parti dhe në përgjithësi në të gjitha segmentet e jetës shoqërore, por nuk ka ndonjë program të veçantë për barazinë gjinore;
- VMRO-DPMNE ka deklarata të përkrahjen e tyre të barazisë gjinore në programin e partisë dhe program të veçantë për barazi gjinore. Kjo parti ka programe konkrete për barazi gjinore në fushatat e tyre parazgjedhore;
- PLM ka deklarata të veçantë partiake për barazi gjinore dhe politikë të elaboruar për barazim gjinor;
- PDSH ka deklarata të përgjithshme për barazi gjinore dhe politikë konkrete për barazim gjinor.
- PSM ka plan aksional për barazi gjinore në organizatën e grave;
- PBERM ka deklarata të përkrahje të plotë për barazi gjinore në programet e tyre, por nuk ka politika konkrete;
- AD ka formulim për përkrahje të plotë të barazisë midis grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës, por nuk ka politikë specifike për barazi gjinore;
- BDI ka deklarata të përkrahjen e barazisë gjinore, por nuk ka formuluar politikë konkrete.

Mund të vërehen shumë ndryshime pozitive në programet partiake. Mungesa e përgjithshme e paragrafave për barazim gjinor në vitin 2002 është se tani vetëm një parti nuk mund të ofrojë diç që ka të bëjë me barazinë gjinore (PPD). Duke e respektuar kuotën si diskriminim pozitiv PPD është e mendimit se gratë duhet të përipiqen për vendin e vet në parti jo vetëm për mes kuotave por me sistemin më demokratik, atë të vlerave.

Të gjitha partitë e tjera kanë nga ndonjë deklaratë për përkrahje të barazisë gjinore. Partitë, të cilat në vitin 2002 kishin deklaratë tani më kanë qasje të elaboruar kurse disa tani zhvillojnë politika konkrete për barazim gjinor në fusha të veçanta.

PREMTIMET ZGJEDHORE LIDHUR ME BARAZIMIN GJINOR NË ZGJEDHJET E FUNDIT NACIONAL

- LSDM: Po, ata kanë premtuar se do të miratojnë Akt për barazi gjinore.
- PLD: Po, ata kanë premtuar se do të sigurojnë prezencën e numrit më të madh të grave në vendet vendimmarrëse.
- PPD: Po, partia premtoi mundësi më të mëdha për gratë që ato të zgjidhen dhe kanë vendosur grua në vendin e parë në listë dhe një tjetër në vendin e tretë por kjo e dyta nuk është zgjedhur.
- VMRO-DPMNE: Po, ata kanë premtuar miratimin e një ligji më të mirë për familjen, ligj kundër dhunës në familje, kujdes të veçantë mjekësorë për gratë dhe personat me kërkesa të veçanta.
- PLM: Po, ata kanë premtuar se do t'iu japin më shumë

shansa grave nga partia e tyre që ato të zgjidhen dhe ia arritën.

- PDSH: premtoi më shumë vende për gratë në listat kandiduese.
- PSM: Po, ata premtuan se do të sigurojnë një hapsirë më të madhe për vendosjen e grave në pozita vendimmarrëse.
- PBERM: ata premtuan se do të sigurojnë më tepër vende për gratë në organet vendimmarrëse në suazat e shoqërisë dhe partisë.
- AD: Jo
- BDI: premtoi se do të kujdesohet për barazi gjinore dhe se do t'ua jep kandidatëve të veta shansën e cila ju takon.

Rritja e vetëdijes për barazi gjinore në suazat e partive politike shpjegohet me faktin se vetëm dy parti nuk kanë përfshirë elemente të barazisë gjinore në premtimet e tyre zgjedhore (PDP dhe AD) dhe se shumica e tyre premtuan më shumë gra të zgjidhen kurse dy parti kanë paraqitur fakte të qarta dhe propozime konkrete për politika lidhur me barazinë gjinore (LSDM dhe VMRO-DPMNE). Fakti që kemi ndryshime të dukshme në qëndrimet parazgjedhore në partitë më të fuqishme tregon se shtypjet që i bëri Lobi i grave të vendit si dhe puna e grave aktiviste brenda partive politike kanë arritur sukses për ta pozicionuar barazinë gjinore në listën prioritare të partive politike. Mund të vërehet se sa ishin serioze partitë kur premtinin se do ta përmirësojnë qëndrimin e tyre lidhur me gratë në partitë politike dhe se do ta avancojnë punën për barazinë gjinore. Gjysma e partive, shumica e tyre nga opozita nuk tentuan t'i drejtohen Qeverisë që ajo të merr hapa konkretë lidhur me barazinë gjinore, por pesë parti me të vërtetë punuan për t'i përmbushur premtimet e veta zgjedhore.

Tabela 4: Iniciativat partiake drejtuar qeverisë për përmirësimin e barazisë gjinore

Partia politike	PO	JO	Propozimi
LSDM	x		Ligj për barazi gjinore
PLD	x		Lobim aktiv për nenin për kuotën 30% në Ligjin për zgjedhje vendore
PPD		x	
VMRO/DPMNE	x		Përkrahje e nenit për kuotën 30% në Ligjin për zgjedhje vendore
PLM	x		
PDSH		x	Përkrahje e nenit për kuotën 30% në Ligjin për zgjedhje vendore
PSM	x		
PBERM		x	
AD		x	
BDI		x	Përkrahje e nenit për kuotën 30% në Ligjin për zgjedhje vendore

Në këtë etapë të zhvillimit të standardeve për barazi gjinore në kornizat e partive politike, kërkesa e LOGM-ja për vendosjen e kuotës prej minimum 30% të burrave dhe grave në Ligjin për zgjedhje vendore është pranuar nga të gjitha partitë si diçka që nënkuptohet.

KONTROLLIMI I REALITETIT- PROPOZIMI I LOGM-së PËR KUOTËN 40% TË BURRAVE DHE GRAVE NË LISTAT KANDIDUESE ME RREGULLAT E EMËRIMIT

Proçesi i reformave të qeverisjes lokale e bëri të mundshme pyetjen për zgjedhjet e ardhshme vendore (lokale) dhe mundësinë për redistribuimin e fuqisë politike dhe ekonomike. Në këtë situatë ËSHTË REALE TË PRITET SE PARTITË NUK DO T'IU JAPIN GRAVE PRANË PARTIVE TË VETA MUNDËSINË E VËRTETË QË TË JENË TË ZGJEDHURA POR DO TË KENË TENDENCË T'Ë VENDOSIN NË FUND TË LISTAVE OSE NË VENDE TË LARTA NË POZITË JO KONKURENTE OSE JO FITUESE.

Ky ishte motivi kryesor pse LOGM-ja me përkrahjen e OSBE-së bëhë thirrje të hapur- duke e përcjellur deri në Parlament dhe ministritë përkatëse si dhe deri te LGM-për amandament i cili do të ngritë minimumin nga kuota e 30% të burrave dhe grave dhe të vendosen rregulla të qarta për emërimin e kandidatëve nga gjinia, e cila është më pak e përfaqësuar. LOGM kërkoi më së paku një vend nga tri vendet e para, dy vende në pesë vendet e para dhe tre vende në tetë vendet e para të cilat duhet t'iu jepen kandidatëve nga gjinia e cila

është më pak e përfaqësuar.

Kjo iniciativë shërbeu si një kontroll e realitetit dhe për nivelin e ndikimit dhe fuqisë të cilën gratë e kanë fituar në suazat e partisë dhe si grupë e interesit me kornizat e shoqërisë qytetare (civile).

Kjo kërkesë e vuri në testim sinjeritetin e udhëheqjes të pjesës mashkullore të partisë si dhe gadishmërinë e tyre për ta ndarë fuqinë me koleget e tyre nga gjinia femërore.

- Grupet politike partiake nuk patën guximin ta përkrahin këtë kërkesë radikale
- LGM-ja s'kishte mundësi për ta përmbajtur për shkak se punon në principe të konsensusit
- Të gjitha partitë politike parlamentare patën qëndrime të ndryshme lidhur me këtë
- Por edhe asnjëra nga gratë parlamentare nuk ishin të gatshme ta përkrahin këtë kërkesë të fuqishme për rregullat në kuotat
- Mediumet, të cilat më së shumti kanë qenë të përkrahur nga LGM-ja ishin skeptikë

Këto ishin tregues se lëvizjet në aspekt të ndryshimeve gjinore dhe fuqisë politike si dhe në kornizat e shoqërisë qytetare, janë ende shumë të brishta dhe munden shumë shpejt të shkaktojnë efekt të kundërt.

Tabela 5: Përkrahja politike për miratimin e rregullës së kuotave në Zgjedhjet vendore

	LSDM	BDI	PLD	PPD	PLM	VMRO/DPMNE	PDSH	PSM	PBERM	AD
Përkrahje e kuotë për 30%	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po
Përkrahje pëmiratimin e rangimit n kornizat e rregullë për kuotat	Po	Po	Po se-cili vend i tre-t	Po	Po se-cili vend i tre-t	Po 15% n nj t tretë e par nga lista	Po 20% nga vendet n dispozici-on	Po secili vend i tret	Jo	Po

Në debatin e ashpër, gratë parlamentare, sidomos ato të cilat janë lidere dhe aktiviste të dukshme të partive dhe LGM-së, nga parti të ndryshme në mënyrë të qetë bëhë lobim për kompromis i cili ishte i pranueshëm.

Në atmosferë të një konfrontimi të vrrullshën mes meshkujve dhe femrave ato arritën ta përfitojnë kompromisin që pason:

30% minimum kuotë për meshkujt dhe femrat candidate dhe së paku nga 30% nga secila gjini duhet të vendosen në pjesën e parë dhe pjesën e dytë të listave.

Kompromisi më në fund u miratua me një avantazh të ngushtë.

Proçesi i përgatitjeve përfundimtare për zgjedhjet e vitit 2005 dhe implementimi i pjesëeishëm i rregullave të miratuara për kuotat treguan se sa është e rëndësishme kjo iniciativë dhe sa i fuqishëm ishte grushti kthyes si pasojë e kësaj iniciative kaq të guximshme.

PREMTIMET ZGJEDHORE PËR BARAZINË GJINORE

Tabela 6: Premtimet partiake për Zgjedhjet vendore më 2005

Partija	Premtimet
LSDM	<ul style="list-style-type: none"> Vendosja e një mekanizmi në nivel komunal për barazi gjinore. Përkrahja për vendosjen e komisionit komunal për barazi gjinore
PLD	<ul style="list-style-type: none"> Zmadhimi i fuqisë politike të grave në nivel lokal Politikë aktive për punësim dhe përkrahje të grave afariste. Aksion konkret për zhdukjen e dhunës në familje Përmirësimi i kujdesit ndaj fëmijëve
BDI	<ul style="list-style-type: none"> Numër më i madh i grave të afta në pozita, të cilat do ta ngrisin statusin e grave në politikë.
VMRO -DPMNE	<ul style="list-style-type: none"> Përkrahje për vendosjen e Komisionit komunal për barazi gjinore Përmirësimi i kujdesit ndaj fëmijëve
AD	<ul style="list-style-type: none"> Përkrahja për vendosjen e komisionit komunal për barazi gjinore Zmadhimi i fuqisë politike të grave në nivel lokal Politikë aktive për punësim dhe përkrahje të grave afariste Finansim nga komuna e programit për përmirësimin e shëndetit riprodaktiv dhe planifikim të familjes Vendosja e SOS linjës kundër dhunës ndaj grave në familje Përmirësimi i kujdesit ndaj fëmijëve
PPD	<ul style="list-style-type: none"> Zmadhimi i fuqisë politike të grave në nivel lokal Politikë aktive për punësimin dhe përkrahje të grave afariste
PDSH	<ul style="list-style-type: none"> Përkrahje për vendosjen e komisionit komunal për barazi gjinore Zmadhimi i fuqisë politike të grave në nivel lokal Politikë aktive për punësim dhe përkrahje të grave afariste Programi financiarisht i përkrahur nga komuna për përmirësimin e shëndetit riprodaktiv të grave dhe planifikimi i familjes Vendosja e SOS linjave kundër dhunës në familje sidomos ndaj grave Përmirësimi i kujdesit ndaj fëmijëve
PLM	<ul style="list-style-type: none"> Përkrahja për vendosjen e Komisionit komunal për barazi gjinore
PBERM	<ul style="list-style-type: none"> Asgjë e premtuar në këtë fushë
PSM	<ul style="list-style-type: none"> Gratë e zgjedhura do të kontribuojnë për përmirësimin e politikës shëndetësore dhe arsimore në nivel lokal Politikë aktive për punësim Preventivë dhe kujdes për shëndetin e grave dhe fëmijëve me përkrahje financiare

Në projektin e ri GMA II, kemi shfrytëzuar pyetësor për t'i inkurajuar gratë nga partitë të mendojnë rreth mundësive për t'i ndihmuar partitë e tyre, të formulojnë ofertë konkrete për politikën për barazinë gjinore në nivel lokal. Është e dukshme se kjo qasje dha rezultate.

Mund të vërehet se si përmes këtij projekti është krijuar konsensus për vendosjen e mekanizmave për barazi gjinore në nivel lokal, si dhe interesim për politikë aktive për punësimin e grave si dhe për përmirësimin e shëndetit riprodaktiv dhe luftë kundër dhunës në familje.

Për herë të parë deri tani 9 parti politike nga 10 të përfshira në projekt kanë integruar politikë për barazi gjinore në premtimet e tyre zgjedhore.

IMPLEMENTIMI I RREGULLAVE PËR KUOTAT –RESPEKTIM I PAMJAFTUESHËM DHE QEVERISJA E DREJTËSISË

Grushti kthyes u bë i dukshëm kur Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) u dërgoi udhëzimet e veta për implementimin dhe rregullat për kuotën.

Në kornizat e kompetencave të veta KSHZ solli udhëzime për zbatimin e nenit 22 nga Ligji për Zgjedhje Vendore.

Citat nga udhëzimi:

- "Për shkak të përfaqësimit me së paku 30 % të secilës gjini në listë si në gjysmën e parë ashtu edhe në pjesën e dytë të kandidatëve për anëtarë të këshillave komunale dhe këshillit të qytetit të Shkupit, llogaritja është bërë sipas rregullave gramatikore: në komunat me 15 anëtarë të këshillit të komunës, përfaqësimi me së paku 30% të gjinive të ndryshme në përgjithësi në listë është 4,5% nga të cilat në pjesën e lartë ose gjysmën e parë të listës nga 7 kandidatë përqindja është 2,1%. Sipas rregullës së zbatuar matematikore numri është rrumbullaksuar me numrin 4 e cila korespondon me nga dy anëtarë në pjesën e parë dhe të dytë të listës." (mbyllja e citatit)

Për këtë udhëzim LOGM dha ankesë deri te Këshilli Shtetëror Zgjedhor, por ata sërish e dhanë interpretimin e njejtë. LOGM

insistonte që KSHZ mos t'i pranojë listat në të cilat ka më pak se 5 gra nga gjithsej 15 kandidatë. Grushti i dytë dhe dëshprim i madh për sundimin e të drejtës u paraqit në formë të listave partiake dhe qytetare të cilat shumë qartë i kanë thyer rregullat e kuotave por nuk u diskualifikuan nga zgjedhjet.

Pasoja nga ky vendim është se 30 lista kanë ndjekur udhëzimin e KSHZ-së dhe ato parti politike sipas mendimit tonë e kanë shkelur fjalën dhe shpirtin e Ligjit.

Komisionet zgjedhore komunale kanë lejuar pjesëmarrje në zgjedhjet vendore e më se 33 listave të cilat nuk e kanë respektuar Ligjin respektivisht 22,17% nga Komisionet Zgjedhore Komunale, kanë lejuar shkeljen e ligjit. Me shtimin e komunave të cilat e kanë miratuar udhëzimin e KSHZ atëherë 22.35% nga komunat kanë bërë thyerje të ligjit.

MOS RESPEKTIMI I LIGJIT


- 33 lista nga parti të ndryshme politike dhe grupe qytetarësh e kanë thyer ligjin
- 30 lista e kanë zbatuar udhëzimin e KSHZ i cili sipas mendimit tonë poashtu është thyerje e ligjit
- 22,17% nga Komisionet Zgjedhore Komunale kanë lejuar thyerje të Ligjit
- Bashkë me komunat të cilat e kanë respektuar udhëzimin e KSHQ janë 42,35%

Sa është i rëndësishëm legjislati për kuotën është shumë transparente nga rezultatet e pikëlluese me gratë prefekte.

Tabela 7

Partija	Komuna	Numri i kandidateve për prefekte
LSDM	Çair, Mogilla, Tetovë, Krushevë	4
PLD	Rankovce	1
BDI	Осломеј, Зелениково	2
VMRO-DPMNE	Çair, Qendër,	2
PSM	Kumanovë	1
PLM	Llozovo	1
PDSH	Butel	1
PPD		0
PBERM		0
AD	Gjevgeli	1

Prefekte



Nga 430 kandidatë për prefekt kishte vetëm 18 (4,18%) gra kandidate. Vetëm njëra ishte ishte e zgjedhur në rrethin e parë, dhe vetëm dy në rrethin e dytë. Nga 10 parti të përfshira në projektin tonë në zgjedhjet që pasonin kishin gra kandidate për prefekte.

Se sa kanë qenë serioz liderët e partive lidhur me premtimet e tyre për zgjedhjen e më shumë grave në këshillat vendore shihet qartë nga vendet të cilat i fituan gratë në tre vendet e para të listës.

Vetëm 10,1% nga të gjitha listat kishin gra në vendet e para.

Tabela 8

Partija	Numri i grave vendi i parë	Numri i grave vendi i dytë	Numri i grave vendi i tretë
LSDM	6	5	20
PLD	3	3	4
BDI	1	1	8
VMRO-DPMNE	7	10	15
PSM	0	0	1
PLM	1	2	0
PDSH	3	9	7
PPD	n/p	n/p	n/p
PBERM	1	0	0
AD	5	9	11
Gjithsej	26	39	66

PËRQINDJA E GRAVE NË TRI VENDET E PARA

10,10 % bartëse të listave janë gra
17,50 % në vendin e dytë janë gra
22,76 % në vendin e tretë të listës

Në të shumtën e rasteve kandidatja e parë femër ishte e vendosur në vendin e tretë, të katërt ose në vendin e pestë.

Partitë e përfshira në projektin tonë e vendosën këtë përqindje të grave në pjesën e parë të listave të tyre:

Tabela 9

Partija	Përqindja e grave kandiduese në pjesën e parë të listës
LSDM;PLD ;PBERM	34.21 %
BDI	30.47 %
VMRO-DPMNE ; PSM ; PLM	33.53 %
PDSH; PPD	29.05 %
AD	35.63%

Tani është e qartë në rregullat për emërimet në ligj qenë me rëndësi të madhe, sepse me të vërtetë iu ndihmuan grave nga partitë të kenë sukses në zgjedhje ose grave kandidatet në viset rurale me numër më të vogël të listave të kompletuara.

Në komunat e Shkupit kjo përqindje ishte 16% në qytetin e Shkupit 22%.

Vetëm 17.50 % nga gratë e fituan vendin e dytë në listë. Vetëm 2.76 % të grave e fituan vendin e tretë.

Në zgjedhjet e vitit 2005 në vend u zgjodhën 22,4% gra fuqia politike dhe ekonomike e bashkësive lokale dukshëm u këshilltare. Kjo do të thotë se përqindja pothuajse është zmadhua me decentralizimin e shtetit!

Tabela 10


Partia	% E grave këshilltare në v. 2005	
LSDM/PLD	113	36.21%
BDI	47	15.06 %
VMRO-DPMNE PSM/PLMLPM	72	23.07%
PDSH/PPDP	23	7.37%
PBERM	1	0.32 %
AD		0.96 %
GJITHSEJ:		82.99%

Partitë e përfshira në projektin tonë e kishin këtë përqindje të grave këshilltare të zgjedhura në zgjedhjet vendore të vitit 2005.

ANALIZA GJINORE E KËSHILLTARËVE TË ZGJEDHUR NËPËR KOMUNA

	Numri i këshilltarëve në opozitë	Numri i këshilltarëve në opozitë	Numri i këshilltarëve në opozitë	Numri i këshilltarëve në opozitë	Grupë zgjedhëse meshkuj	Grupë zgjedhëse gra	GJITHSEJ
MJEDISE RURALE	185 13.2 %	152 10.9%	64 4.6%	35 2.5%	25 1.49%	3 0.21%	464
MJEDISE URBANE	323 23.22 %	370 26.59 %	106 7.62%	99 7.11%	22 1.58%	7 0.50%	927
GJITHSEJ	508 36.50 %	522 37.5%	170 12.2%	134 9.6%	47 3.37%	10 0.71%	1391

Gjithsej të zgjedhur këshilltarë



PËRFUNDIME

Pa dallim se kishte vështirësi dhe grushte kthyes me thyerjen e ligjit në të gjitha ato raste, këto zgjedhje lokale ishin një hap i madh në ndërtimin e fuqisë politike të grave në nivel lokal.

Ky projekt kontriboi shumë për këtë sukses:

- Partitë politike relevante për vendin e përmirësuar propagandimet e tyre edhe përfshirjen e politikës konkrete për barazi gjinore si në premtimet zgjedhore ashtu edhe në fushatën zgjedhore.
- Përqindja e grave kandidatë për prefekte dhe këshilltare dukshëm është zmadhuar.
- Vendosja e rregullave për emërtime në dispozitat për kuotët të cilat u propozuan nga OJQ e cila ishte edhe implementuese e këtij projekti dhe lobimi këmbëngulës nga LOGM dhe gratë parlamentare, kontribuan për vende më të mira të grave në listat në nivel lokal. Ato pothuajse e trefishuan përfaqësimin e tyre në suazat e këshillave lokale.
- Ka konsensus në të menduarit e të gjitha partive politike në lidhje me implementimin e barasisë gjinore në nivel lokal; duhet të vendosen komisione për barazi gjinore, duhet zhvilluar aktivitete për punësim dhe masa konkrete për parandalimin e sëmundjeve reproduktive dhe lufta kundër dhunës në familje ndaj grave dhe përmirësimi i kujdesit për shëndetin e fëmijëve...

Poashtu ky projekt tregoi se sa shumë punë duhet bërë:

- LOGM nuk ishin aq të fuqishme për ta ndaluar thyerjen e sundimit të së drejtës nga ana e Komisionit Zgjedhor Shtetëror, nga komisionet zgjedhore lokale dhe nga partitë dhe grupe qytetarësh .
- Grupet e grave në suazat e partive, akoma janë të pafuqishme për të ndikuar dhe për të bërë shtypje në liderët partiakë që mos të premtohet më tepër se sa duhet.
- Si duket më së shumti mbetet të bëhet në partitë e pakicave nacionale , të cilat si duket kanë më së shumti vështirësi për t'i ndjekur rregullat ligjore . Ato kanë nevojë për një kujdes të veçantë nga partnerët e vendit si edhe ata ndërkombëtarë.

Përgatitur nga Sonja Llokar
Kryesye e Paktit të Stabilitetit
Detyra e Fuqisë Gjinore

PROJEKT NACIONAL

GRATË MUND T'IA ARRIJNË II-
ZGJEDHJET VENDORE 2005

VËNIA E KONCEPTIT GJINOR NË PARTITË
POLITIKE NË NIVEL LOKAL

Botues:
LOGM

Realizues:
Savka Todorovska – LOGM
Elena Grozdanova – MPPS, SPBGJ

Expert Analitik:
Sonja Lokar – SP GTF

Assistente:
Danica Jovanova
Svetlana Cvetkovska

Lekturimi:
Daniela Antonovska

Përkhtim:
Lirija Shabani – Gjuhe Shqipe
Aneta Ilievska – Gjuhe Angleze

Dizajni dhe Perpunimi Kommpjuterik:
Koma Lab. – Skopje

Proekti është përmbaytur NGA OSBE -
Misioni Vëzhgues në Shkup

Shtypi:
Vinsent Grafika

Tirazhi:
200 Kopje ne Gjuhen Macedonias
200 Kopje ne Gjuhen Angleze
100 Kopje ne Gjuhen Shqipe

Skopje, 2005

**Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të thotë se
përfaqëson këndvështrimin dhe qëndrimin e
Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup**